



Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" (UP) dhe Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) mbi bazën e konsultimeve, diskutimeve dhe angazhimeve konkrete të zhvilluara, në mbështetje të nenit 4 paragrafit 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsim të Lartë në Republikën e Kosovës dhe nenit 6 paragrafit 2.6 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, duke u mbështetur në interesat e përbashkëta, që kanë për qëllim avancimin dhe ngritjen e arritjeve profesionale në arsimimin e lartë, bashkëpunimit shkencor, arsimor dhe akademik në mes të institucioneve, hapjen e mundësive të reja të bashkëpunimit për studentët, stafin akademik dhe administrativ, me datën _____ 2024 e lidhin këtë:

MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

Pranuar me dt. 21.12.2024			
Nj. org.	Numër	Nr. ekzempl.	Vlera
01	586		

Në mes të

UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" (UP)
dhe
AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT (ARRU)

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit në mes të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (në tekstin e mëtejme UP) dhe Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit (në tekstin e mëtejme ARRU), me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave profesionale, këshillimit, trajnimeve, si dhe angazhimit të studentëve në projektet e ARRU-së për zhvillimin e praktikës profesionale.

Neni 2

Fushëveprimi

ARRU-ja dhe UP-ja, do të bashkëpunojnë për rritjen e kapaciteteve Institucionale përkatëse, përmes bashkëpunimit të drejtëpërdrejtë të ARRU me njësitë akademike përmes aneks marrëveshjeve për hartimin e ekspertizave, analizave dhe studimeve të përbashkëta, ngritjen profesionale të studentëve dhe të programeve të studimeve në fushat: Inxhinieri e Ndërtimit, Ekonomi, Drejtësi apo programe të tjera që mund të identifikohen në të ardhmen.

Neni 3

Zotimet dhe detyrimet ndërmjet palëve

- UP-ja, përkatësisht njësitë akademike të fushave të inetersit për bashkëpunim me ARRU- në do të hartojnë anekse të bashkëpunimeve duke marrë për bazë këtë marrëveshje të bashkëpunimit dy palësh.
- Interesi i ARRU-së për bashkëpunim lidhet me njësitë akademike: Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti Juridik.
- ARRU-ja merr përsipër draftimin e aneks marrëveshjeve me njësitë akademike si në paragrafin 2 të këtij neni, lidhur me çështjet objekt të kësaj Marrëveshjeje.

- ARRU-ja angazhon njërin nga zyrtarët e saj në rolin e Koordinatorit të punës ndërinstytucionale në realizimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4 Zbatimi

- Marrëveshja e bashkëpunimit shpreh vullnetin e dy palëve për bashkëpunimin institucional me qëllim të përgatitjes dhe avancimit profesional të gjeneratave të ardhshme për tregun e punës në vend.
- Palët përcjellin implementimin e kësaj Marrëveshjeje dhe udhëzojnë për veprimet, të cilat duhet të ndërmerren, në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në këtë dokument.
- Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje janë të mundshme vetëm me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve dhe do t'i shtohen këtij dokumenti si pjesë integrale e tij.

Neni 5 Kohëzgjatja dhe përfundimi

- Marrëveshja do të jetë në fuqi për periudhë kohore dy (2) vjeçare, ndërsa mund të rinovohet ose zgjatet me marrëveshje të përbashkët me shkrim të palëve.
- Secila palë e cila dëshiron të ndërpres këtë Marrëveshje, do ta njoftojë paraprakisht palën tjetër me shkrim për këtë qëllim, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e synuar për përfundim.

Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje si rezultat i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht ndërmjet palëve.

Neni 7 Dispozita përfundimtare


Kjo Marrëveshje nënshkruhet në katër (4) kopje origjinale në gjuhën shqipe, dy (2) prej të cilave mbeten në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe dy (2) tek Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit.

Neni 8 Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e institucioneve.

Palët nënshkruese të marrëveshjes:

Universiteti i Prishtinës


Prof. Dr. Qerim Qerimi
Rektor

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit


MSc. Hajrije Morina
Drejtor